DRTK SHKODËR
SEKTORI AAAMTK

MIRATOHET

Për K. K. T. K. M
Sekretari
Joli Mitrojorgji

RELACION TEKNIK

PUNIME RESTAURIMI NË MONUMENTIN "BANESA E RAMIZ PODGORICËS"



SHTATOR 2025

PËRMBAJTJA :

Hyrje

Vendodhja

Përshkrimi arkitektonik

Problematika dhe ndërhyrje

Hyrje

Objekt i këtij projekti restaurimi është pasuria kulturore banesa e "Ramiz Podgorices" në Shkodër.

Faza e parë e një projekti restaurimi është ajo e konsultimit të materialeve arkivore, hulumtimi i materialeve historike që disponon DRTK Shkodër në lidhje me këtë objekt si dhe studimi i materialeve të vëna në dispozicion nga IKTK Tiranë. Kjo fazë është e rëndësishme për të ndërtuar kronologjinë historike të pasurisë kulturore, dokumentimin e ndërhyrjeve restauruese të mëparshme, si edhe evidentimin e ndryshimeve që kanë ndodhur me kalimin e kohës. Puna kërkimore është pasuar nga rilevimi fotografik i objektit që do të restaurohet, rilevimi gjeometrik për të vazhduar pastaj me rilevimin arkitektonik.

Rilevimi gjeometrik ndihmon në vizatimin e saktë të planimetrive, ndërsa rilevimi fotografik vjen në ndihmë të dokumentimit të zonave ku do të fokusohen këto ndërhyrje.

Një rilevim arkitektonik i kujdesshëm dhe evidentim sa më i detajuar i degradimeve do të ndihmojë për hartimin e një projekti restaurimi sa më të plotë dhe efikas.

Materiali është i organizuar si më poshtë: pjesa që i përket studimit historik të objektit, përshkrimi arkitektonik i saj, për të vazhduar me problematikat, ndërhyrjet, specifikimet e ndërhyrjeve restauruese.

Vendodhja

Banesa e Ramiz Podgoricës ndodhet në qytetin e Shkodrës, në rrugën Isuf Sokoli. Ajo është pasuri kulturore me status monument kulture kategoria e I-rë, shpallur nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës me Urdhëres të datës 08.01.1977.



Fig 1. *Harta e Shqipërise, evidentim i Qarkut Shkodër*



Fig 2. *Ortofoto, evidentim i banesësë me pikë të kuqe*

Përshkrimi arkitektonik

Banesa e "Ramiz Podgoricës" është një ndërtim dy katësh. Ajo i përket një tradite të konsoliduar të arkitekturës vernakulare të shekujve XVIII–XIX, dhe ruan mirë skemën planimetrike dhe funksionale të banesës shkodranë. E ndërtuar me muraturë guri, që kapin një trashësi mbi 60 cm, të suvatuara me llaç gëlqere duke i shtuar banesës stabilitet dhe izolim termik. Në katin përdhes zakonisht ndodhen hapësirat e shërbimit, depo etj, ndërsa kati i sipërm është i destinuar për banim. Shkalla e gurit që të shpie në katin e parë të saj është e pozicionuar brenda. Çatia është ndërtuar me konstruksion prej druri, dhe mbulimi i saj është me tjegulla vendi, element tipik i banesës shkodrane. Dritaret e banesës të pajisura me korniza druri dhe hekura dekorativë, janë reflektojnë estetikë dhe funksionalitet. Të dimensioneve të mëdha për të siguruar ndriçim dhe ajrosje, në të njëjtën kohë ata ofrojnë privatësi dhe siguri. Të projektuara njëra pas tjetrës, ato krijojnë një ritëm në artikulimin e fasadës. Pozicionimi i tyre në drejtim të oborrit, është tregues i qartë i lidhjes mes hapësirës së brendshme dhe asaj të jashtme. Të gjtha këto elemente si muret prej guri, shkallët e brendshme prej guri, çatia me konstruksion druri dhe e mbuluar me tjegulla vendi, e bëjnë këtë banesë pjese e shembujve përfaqësues të arkitekturës qytetare shkodrane. Këto ndërtime ndërhurin më së miri funksionin me estetikën, si dëshmi e traditës ndërtimore dhe identitetit kulturor të qytetit.



Fig 3. *Foto e fasadës kryesore të banesës*

Problematika dhe ndërhyrje

Banesa pasuri kulturore me status monument kulture kategora e I-rë ruhet në gjendje relativisht të mirë. Të gjithë ndërtesat historike, pas kalimit të një farë kohe jane objekt degradimi progresiv. Faktorët se pse ndodh kjo janë: ekspozimi natyror ndaj motit të keq; fatkeqësitë si zjarret apo tërmetet; nga braktisja ose nga dora e njeriut. Këto faktorë mund të veprojnë vetëm ose duke u ndërthurur njëri me tjetrin. Kjo banesë nuk paraqet problematika që lidhen me strukturën, por është menduar që të hartohet një projekt restaurimi pjesor. Në çdo banesë të vjetër është e nevojshme për ndërhyrje periodike mirëmbajtje, në mënyrë që të sigurohet në gjendje sa më autentike të gjithë elementet fillestarë me të cilët është realizuar edhe ndërtimi.
Si problematikë që ky projekt ka evidentuar janë dritaret e objektit të pozicionuara në katin përdhe dhe atë të parë. Dritaret janë prej duri, dhe ato që janë të vendosura sot, vërehen se janë të degraduara nga prezenca e lageshtisë, ka edhe mungesë të elementeve drusore. Gjithashtu edhe muratura e katit përdhe është e degraduar, është parashikuar prishja e suvase të degraduar dhe aplikim i suvasë së re në zonat e parashikuara në projektin teknik. Në katin përdhe janë gjurmët e dritareve që jane mbyllur në vite, është parashikuar që të bëhet heqja e muraturës dhe vendosja e dritares së drurit duke ruajtur madhësinë e hapjes dhe materialin e ngjashëm me dritaret e tjera - dru.

Foto të gjendjes aktuale



Fig 4,5. *Foto të dritareve të degraduara*





Fig 6,7. *Foto të gjurmës së dritares të mbyllur*



Fig 8. *Foto e ambientit të katit përdhe*



Fig 9. *Foto e dritares prej druri të degraduar*

Punoi: Fatjon MLLOJA

Sabrina KUÇI

Elson LAQJA

Miratoi

Petrit Bilali

Shef sektori AAAMTK

Drejtor

Helidon Sokoli

Fatjon Mlloja Digitally signed by Fatjon Mlloja Date: 2025.11.21 14:13:31 +02'00'

Elson Laqja Digitally signed by Elson Laqja Date: 2025.09.25 14:20:05 +02'00'

Sabrina Kuci Digitally signed by Sabrina Kuci Date: 2025.09.25 15:44:08 +02'00'

Helidon Sokoli Digitally signed by Helidon Sokoli Date: 2025.10.07 09:30:09 +02'00'

Kiara Xhelili Digitally signed by Kiara Xhelili Date: 2025.11.21 13:12:07 +02'00'

Vulosur elektronikisht nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore
Date: 2025/11/21 13:18:29 +02'00'
4167031181fb4ad8bac0553a064a7c5

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore)